

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“RIMA KONSULENCË ” SH.P.K

Sot, më datë 14/11/2024 (dy mijë e njezet e kater), **Z.nj FEDERICA BALDI**, shtetase Italine, i datëlindjes 04/04/1977, lindur në Itali(Milano), dhe banues ne Itali (Chiarella), Rruga Isonzo 54-20084, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes me numer AT6315064.

Z. MATTIA RINALDI shtetas Italian, i datelindjes 20/08/1989 lindur ne Monza (Itali) dhe banues Lugano, Piazzetta San Giuseppe nr 2, person madhor e me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes me numer CA75899AC.

Vendosem te themelojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1
Themelimi

Emri i shoqerise eshte "RIMA KONSULENCË" Sh.P.K. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "RIMA KONSULENCË" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë. Shoqeri Fitprurese.

Qëllimi i krijimit të kësaj shoqerie eshte fitimprurese ajo do te zhvilloje veprimtarine e saj ne :Ne fushen e sherbimeve te dryshme ndermjetesim etj.

NENI 3
Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin " RIMA KONSULENCË " SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4
Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është: Gjetjen e klientëve për interes të palëve të treta, krijimin dhe menaxhimin e faqeve të internetit dhe fushatave web, si dhe kërkimin e klientëve nëpërmjet aktiviteteve të call center-it për llogari vetjake dhe për të tretët. Ofrimin e shërbime tregtare, analiza dhe kërkime tregu, dërgimin e e-maileve në grupe (mail list), organizimin e fushatave promocionale me SMS dhe fushatave publicitare, si në format fizik (kartelina, broshura, etj.) ashtu edhe online. Aktivitetet përqendrohen kryesisht në gjetjen e klientëve të rinj dhe realizimin e takimeve ndërpersonale. Shoqëria mund të ofrojë shërbime marketingu, konsultime për plane marketingu dhe aktivitete mbështetëse si informim, asistencë dhe ndërmjetësim, duke synuar zgjerimin e biznesit në Zvicër dhe jashtë saj. Gjithashtu, përfshin organizimin e eventeve, konferencave dhe aktiviteteve të



udhëtimit, menaxhimin e agjencive martesore dhe organizimin e takimeve, si online ashtu edhe fizike. Shoqëria mund të operojë si agjenci imobiliare, duke ofruar ndërmjetësim për pasuri të patundshme dhe financiare, blerjen, shitjen dhe administrimin e pasurive të paluajtshme për llogari vetjake dhe për të tretët. Gjithashtu, mund të merret me tregti të automjeteve, motoçikletave dhe skuterëve të rinj ose të përdorur, përfshirë shitjen online, dhe të ofrojë shërbime me qira për këto mjete. Shoqëria mund të angazhohet edhe në aktivitete të franchising dhe operacione të tjera të ngjashme, të lejuara nga legjislacioni në fuqi.

NENI 5 **Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Bashkinë Tiranë, njesia nr 7, rruga Nikolla Lena, ish markata vjeter, njesia nr 9 zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 6 **Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 (nje qind mije) lek, Ortaket themelues **znj FEDERICA BALDI, Z. MATTIA RINALDI** te Shoqërisë Tregtare "RIMA KONSULENCË" **SH.P.K** zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- **Znj FEDERICA BALDI**, shtetase Italiane, i datëlindjes 04/04/1977, lindur në Itali (Milano), dhe banues ne Itali (Chiarella), Rruga Isonzo 54-20084, mbajtës i kartes me numer AT 6315064 zoterues i 90 % te kuotave te perbere nga 90.000(nentedhjete mije) leke duke perfaqsuar 90 % te kapitalit.

Z. MATTIA RINALDI shtetas Italian, i datelindjes 20/08/1989 lindur ne Monza (Itali) dhe banues Lugano, Piazzetta San Giuseppe nr 2, person madhor e me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes me numerCA75899AC, zoterues i 10 % te kuotave te shoqerise te perbere nga 90. 000 (dhjete mije) leke duke perfaqsuar 10 % te kapitalit.

Pergjegjësia e ortakeve shtrihet deri ne shumen e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar .

NENI 7 **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8 **Administratori**

Shoqëria administrohet nga 2 Administratore te cilet zgjidhen për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë do të jetë **Znj FEDERICA BALDI**, shtetase Italiane, i datëlindjes 04/04/1977, lindur në Itali (Milano), dhe banues në Itali (Chiarella), Rruga Isonzo 54-20084, mbajtës i kartes me numer AT 6315064.

NENI 9

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, të cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkruan pa urrejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

FEDERICA BALDI

MATTIA RINALDI